1	<i>Fondet për personelin mësimor në kopshte në arsimin parashkollor</i>	<i>3,609,018,000</i>
2	<i>Fondet për personelin mbështetës në kopshte dhe arsimin parashkollor</i>	<i>1,018,729,000</i>
3	<i>Fondet për personelin mbështetës në arsimin parauniversitar</i>	<i>470,375,000</i>
4	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e mbrojtjes nga zjarri</i>	<i>1,135,209,000</i>
5	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e administrimit të pyjeve</i>	<i>310,941,000</i>
6	<i>Fondet për personelin dhe shpenzimet operative për funksionin e ujëtyjes dhe kullimit</i>	<i>847,538,000</i>
7	<i>Fondet për qendrat e shërbimeve sociale</i>	<i>19,190,000</i>
II I	Transferta e pakushtëzuar për tu shpërndarë me formulë në vitin 2019 (I.4+I.8+II.1)	19,926,420,548

Pjesa e Përgjithshme e Transfertës së Pakushtëzuar (TP) për vitin 2019 është 1% e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të parashikuar për vitin 2019, ose 17,527,360,000 Lekë, 6.1 % ose rreth 1 miliard lekë më shumë se në vitin 2018. Gjithsej transferata e pakushtëzuar që shpërndahet nëpërmjet formulës është 15,990,402,548 lekë, pas zbritjes së fondeve për konviktet, shërbimet sociale, bashkitë të regjistruara në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, për rrugët rurale dhe për mbështetjen e reformës në arsimin parashkollor. Deri para vitit 2016, fondet për konviktet, shërbimet sociale dhe bashkitë në Lisën e UNESCO-s, inkorporoheshin në transfertën e pakushtëzuar përfundimtare të bashkive respektive. Me hyrjen në fuqi të formulës së re të ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, meqenëse ndarja e fondeve për këto funksione nuk ishte pjesë e formulës, për të rritur transparencën këto fonde janë nxjerrë jashtë totalit të transfertës që ndahet me formulë. Duke filluar nga viti 2016, këto fonde paraqiten vetëm tek bashkitë përfituese si transfertë e pakushtëzuar, sikurse paraqitur në **tabelën nr. 3** pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2019. Në totalin e transfertës së pakushtëzuar përfshihen edhe fondet për mirëmbajtjen e rrugëve rurale, që nga 2016 kanë kaluar nga këshillat e qarqeve tek bashkitë. Gjithashtu, fondet për këtë funksion nuk ndahen sipas formulës së transfertës së pakushtëzuar dhe paraqiten të veçanta për bashkitë përfituese në tabelën nr. 3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2019.

Në vitin 2019, në zbatim të nenit 28 dhe 37 të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 23 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 23 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, do të ndërmerret një reformë në sistemin e financave të arsimit parashkollor duke e harmonizuar sistemin me praktikën më të mira ndërkombëtare në financimin e kopshteve. Kjo reformë pritet të sjellë një përmirësim të rëndësishëm në cilësinë e arsimit parashkollor në vendin tonë duke sjellë rritjen e numrit të edukatoreve. Kostoja e reformës është 327 milion lekë dhe do të mbulohet nga rritja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2019.

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Fondet për këto funksione nuk ndahen sipas formulës së ndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përcaktuar në nenin 24 të Ligjit nr. 68, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Fondet për këto funksione ndahen për çdo funksion dhe për çdo bashki, sipas kriterëve specifikë të përcaktuara në Aneksin nr. 4 dhe në kolonat e veçanta në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse të ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2019.

Buxheti i vitit 2019, shënon fillimin e një reforme të rëndësishme në sistemin arsimor dhe vendos një standard të ri në arsimin parashkollor. Duke filluar nga viti 2019, konform kuadrit ligjor në fuqi dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, fondet për arsimin parashkollor do të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve me moshë 3-6 vjeç, si treguesi më i mirë i nevojës për shërbim dhe pjesërisht do të bazohet në sistemin aktual të ndarjes së fondeve sipas numrit të edukatoreve të transferuara në vitin 2016 deri në 2018. Më specifikisht, duke filluar nga janari i vitit 2019, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve do të ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Kjo reformë siguron një ndarje

më të mirë të fondeve, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që duhet t'u ofrohet edukimi parashkollor, por njëkohësisht siguron një tranzicion gradual që minimizon kostot, duke ruajtur 40% të kriterit të sistemit aktual. Reforma është plotësisht në përputhje me parashikimet e nenit 28 dhe 37 të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" dhe praktikat e mira ndërkombëtare që rekomandojnë një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Ndryshimi i sistemit të ndarjes së fondeve për arsimin parashkollor në vendin tonë përbën një domosdoshmëri, pasi sistemi aktual nuk reflekton në mënyrë të saktë ndryshimet sociale, demografike dhe infrastrukturore që kanë ndodhur përgjatë më shumë se dy dekadave të fundit. Kjo domosdoshmëri njihet edhe nga legjislacioni aktual për arsimin parauniversitar në Shqipëri, i cili sugjeron një ndarje të fondeve, kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve.

Kjo reformë siguron:

- Uljen e madhësisë mesatare të grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.

- Shtimin e fondeve në ato bashki ku ka një nevojë reale për shtimin e numrit të edukatoreve duke ulur madhësinë maksimale të grupeve nga 26 apo 25 fëmijë për një edukatore në 18 fëmijë për edukatore, një parakusht për përmirësimin e cilësisë së edukimit për fëmijët nga 3-6 vjeç që ndjekin kopshtet publike. Shtimi i numrit të edukatoreve nënkupton edhe shtimin e kapaciteteve të shërbimit, duke ulur kështu nevojën për dërgimin e fëmijëve në kopshte private.

- Ruajtjen e fondeve aktuale për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.

- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit fëmijë për edukatore;

Kjo reformë, bën një ndarje më të drejtë të fondeve ndërmjet bashkive, zbut diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit "fëmijë për edukatore" dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve. Në vitin 2019, asnjë bashki nuk do të rezultojë me humbje nga kjo reformë. Bashkitë që rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatorësh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, dhe që kanë një madhësi mesatare të grupeve të fëmijëve me 6 apo 9 fëmijë për edukatore nuk do të kenë asnjë humbje pasi do të kompensohen plotësisht. E thënë ndryshe, këto bashki do të vazhdojnë të marrin të njëjtin nivel fondesh që kanë marrë në vitin 2018.

Në buxhetin e vitit 2019, do të ndahen me formulën e rishikuar të transfertës së pakushtëzuar 19,926,420,548 lekë, e cila përfshin edhe 3,609,018,000 lekë për personelin mësimor në arsimin parashkollor. Fondet e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të reja të transferuara në vitin 2016, paraqiten në tabelën nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2019 dhe nuk pësojnë ndryshime në raport me vitin 2018.

3. Ndarja e Transfertës së Pakushtëzuar ndërmjet dy niveleve të Qeverisjes Vendore

Për vitin 2019, për financimin e funksioneve të veta Bashkitë marrin **97.5%** të totalit të transfertës së pakushtëzuar së parashikuar për t'u ndarë me formulë, ose **19,426,420,407 lekë**. Funksionet e reja të transferuara te bashkitë në vitin 2016, financohen nëpërmjet transfertave të pakushtëzuara sektoriale me kolona të veçanta në tabelën nr.3 pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2019. Fondet për arsimin parashkollor në këtë buxhet janë shpërndarë sipas një formule e cila mbështetet kryesisht në numrin e fëmijëve me moshë 3-6 vjeç.

Ndarja e Transfertës së Pakushtëzuar ndërmjet dy niveleve të Qeverisjes	Në përqindje	Vlera në lekë
Transferta e Pakushtëzuar për Bashkitë	97.5%	19,426,420,407
Transferta e Pakushtëzuar për Qarqet	2.5%	500,000,000

Për vitin 2019, Qarqet marrin 2.5 % të transfertës së pakushtëzuar ose 500 milion lekë. Në vijim të transferimit të funksionit të rrugëve rurale nga qarqet tek bashkitë, fondet e shpenzuara nga qarqet për këtë funksion i transferohen bashkive sipas tabelës nr. 3, pjesë përbërëse e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2019.

4. Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë

Popullsia është një tregues i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Për rrjedhojë popullsia do të vazhdojë të mbetet kriteri kryesor për ndarjen e transfertës së pakushtëzuar ndërmjet

njësive të vetëqeverisjes vendore.

Koeficienti i përshtatjes së të dhënave të popullsisë	30%
Banorë rezidentë efektivë = $\text{ëCENSUS} + (\text{Regjistri i gjendjes civile} - \text{Census}) * 30\%$	3,296,828

Të dhënat për popullsinë që përdoren në aplikimin e formulës bazohen kryesisht në të dhënat e Censusit të vitit 2011. Këtyre të dhënave u shtohet 30% e diferencës midis të dhënave të Censusit dhe Gjendjes Civile (të vitit 2018) për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore. Kështu, nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore sipas Censusit të vitit 2011 ka 30,000 banorë, ndërsa sipas Regjistrit të Gjendjes Civile rezultojnë të ketë 45,000 banorë, atëherë, numri i popullsisë së përdorur për alokimin e fondeve për këtë bashki do të jetë $30,000 + \{(45,000 - 30,000) * 30\} = 34,500$ banorë të konsideruar rezidentë efektivë në atë njësi të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë, popullsia rezidente rezultojnë rreth 3.3 milion banorë, nga 2.8 milion që raportohet nga Censusi dhe 4.4 milionë që raportohet nga Regjistri i Gjendjes Civile. Vlerësohet se një kompromis midis dy burimeve të të dhënave është i nevojshëm dhe rregullimi me 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe Censusit amortizon ndryshimet në transfertë që do të pësonte një njësi nga kalimi nga një formulë në tjetrën.

5. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Bashkitë.

Për vitin 2019, transfertat e pakushtëzuar e cila ndahet sipas formulës për 61 bashkitë është 19,426,420,407 lekë dhe do të ndahet sipas kriterëve të mëposhtme. Kriteret e shpërndarjes së fondeve në formulë kërkojnë të identifikojnë nevojat reale të shpenzimeve të njësive të ndryshme të vetëqeverisjes vendore mbi bazën e popullsisë, dendësisë së popullsisë dhe numrit të fëmijëve në kopshte dhe nxënësve në shkollat publike 9-vjeçare dhe të mesme në territorin e një bashkie.

Në formulë, 64% e transfertës për bashkitë alokohet mbi bazën e popullsisë relative. Në vijim të rregullimit të numrit të popullsisë së Censusit duke i shtuar atij edhe 30% të diferencës midis të dhënave të Gjendjes Civile dhe të dhënave të Censusit, çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr një transfertë të pakushtëzuar prej 3,759 lekë, për çdo banor rezident në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë	19,426,420,407
Komponenti I: Ndarja sipas popullsisë (në përqindje)	64%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	12,392,322,039
Transferta e pakushtëzuar për frymë	3,759

Dendësia e popullsisë është një kriter tjetër që përdoret për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë. Dendësia e popullsisë më e ulët është në bashkitë që përbëhen kryesisht ose plotësisht nga zona rurale dhe/ose malore. Ka një korrelacion të fortë mes njësive të vetëqeverisjes vendore me dendësi të ulët dhe atyre sipërfaqja e të cilave është mbi 50% malore. Kështu koeficienti, “dendësi e ulët e popullsisë”, çon fonde shtesë në të njëjtin drejtim siç bënte formula e mëparshme e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar, nëpërmjet përdorimit të koeficientëve shtesë për njësitë vendore malore dhe në vështirësi financiare.

Në formulë 12 % e totalit të fondit për bashkitë, ndahet mbi bazën e dendësisë së popullsisë, e cila ndahet në kufij sipas tabelës së mëposhtme.

Komponenti II: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							12%
Madhësia e Transfertës së Pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							2,322,560,382
Mesatarja Kombëtare e Dendësisë së Popullsisë							116 banorë/km ²
Transferta për frymë nga densiteti i popullsisë							2,001 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët e rregullimit	Numri i NJVV-ve përfituese	Dendësia e popullsisë korresponduese	Popullsia në çdo grup	Popullsia e korrektuar me koeficientin e rregullimit për çdo grup	Shuma e fondeve shtesë për çdo grup	
Kufiri 1	22%	2.32	10	25.6	115,812	268,685	537,648,170
Kufiri 2	44%	1.66	13	51.1	279,710	464,878	930,238,603

Kufiri 3	75%	0.90	10	87.1	347,453	312,707	625,739,327
Kufiri 4	110%	0.40	6	127.8	286,019	114,408	228,934,282
	>110%	0.00	0	0	0	0	0
Totali			39		1,028,994	1,160,678	2,322,560,382

Një njësi e vetëqeverisjes vendore me një sipërfaqe të madhe dhe një popullsi më të ulët, nënkupton, për të gjitha kushtet e tjera të barabarta, të ketë kosto më të larta të ofrimit të shërbimeve, rrugë më të gjata dhe shpenzime të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Për të kompensuar njësitë me dendësi më të ulët për kostot më të larta të shërbimit janë krijuar 4 grupime të njërive të vetëqeverisjes vendore sipas ngjashmërisë më të madhe të dendësisë. Njësitë me dendësi më të ulët popullsie përfitojnë nga koeficientë shtesë më të lartë se ato njësi të cilat kanë një afërsi më të madhe të dendësisë me mesataren kombëtare. Nga ky kriter përfitojnë 39 njësi të vetëqeverisjes vendore, në të cilat banojnë 1,028,994 banorë rezidentë efektivë. Nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka një dendësi mesatare nën 22% të mesatares kombëtare, ose mesatarisht 26 banorë për km², atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me 2.32. Nëse ka një dendësi midis 22% dhe 44% të mesatares kombëtare, atëherë popullsia e saj relative do të shumëzohet me një koeficient prej 1.66. Pra duke u afëruar mesatares kombëtare, koeficientët vijnë duke u zvogëluar. Në përfundim numri i popullsisë për çdo grup dendësie, shumëzohet me koeficientin përkatës dhe transfertën për frymë prej **2,001 lekë** për banorë (që rezulton nga pjesëtimi i shumës prej **2,322,560,382 lekë** me popullsinë totale që rezulton nga aplikimi i koeficientëve për çdo grup).

Kriteri i tretë mbi të cilin ndahet transfertat e pakushtëzuar për bashkitë është numri i fëmijëve në arsimin parashkollor i kombinuar me numrin e personelit mësimor në arsimin parashkollor, dhe numri i nxënësve në shkollat publike nëntë-vjeçare dhe të mesme. Duke filluar nga viti 2019, në zbatim të pikës 4 të nenit 23 dhe nenit 24 të Ligjit 68 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar përditësohet për të akomoduar përfshirjen dhe ndarjen e fondeve për pagat e personelit mësimor në sistemin arsimor parashkollor. Në këtë kuadër, komponenti i arsimit i formulës së transfertës së pakushtëzuar do të ndajë gjithsej 24% e totalit të transfertës për tu ndarë me formulë, ose 4,711,537,986 lekë. Nga kjo shumë, 3,936,017,860 lekë janë të dedikuara për pagat e personelit mësimor në arsimin parashkollor. Fondet ndahen 60% mbi bazën e numrit të fëmijëve të regjistruar në kopshte dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve pranë këtyre kopshteve. Në krahasim me vitin 2018, fondet për pagat e personelit mësimor të arsimit parashkollor janë 327 milion lekë ose 9.1% më të larta.

Ndërkohë, pjesa prej 5% e totalit të transfertës, ose 774,520,127 lekë do të ndahet mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike në çdo bashki, kundrejt totalit kombëtar të nxënësve. Bashkitë do të marrin një fond prej 1,869 lekë për çdo nxënës në territorin e tyre.

Komponenti III: Ndarja sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve (në %)	24%
Transferta e pakushtëzuar sipas numrit të fëmijëve dhe nxënësve, në lek	4,711,537,986
Vlera Për personelin mësimor në arsimin parashkollor, në lek	3,936,017,860
Sipas numrit të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme	774,520,127

6. Ekualizimi i transfertës së pakushtëzuar mbi bazën e të ardhurave nga taksat e ndara dhe në raport me transfertën e vitit të mëparshëm.

Për të siguruar një ekualizim horizontal efektiv të transfertës së pakushtëzuar ndërmjet njërive të vetëqeverisjes vendore në mënyrë që të merren në konsideratë kapacitetet e ndryshme fiskale ndërmjet tyre, në formulë llogaritjet bazohen mbi të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, të cilat mbledhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatim fitimi i thjeshtuar i biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridikë të cilat mbledhen nga agjenci qendrore dhe u transferohen njërive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë mënyrë njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurohen që të ardhurat që ata mbledhin vetë nuk preken nga sistemi i ekualizimit duke evituar kështu çdo lloj disincitivimi në mbledhjen e taksave. Në vitin 2017, pjesa e të ardhurave nga këto taksa që u janë transferuar njërive të vetëqeverisjes vendore është 1.8 miliardë lekë, dhe të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), ose mesatarja kombëtare për frymë rezulton 536 lekë për banor, sipas konceptit

“banor rezident efektiv”.

Komponenti IV: Sistemi i Ekualizimit të të ardhurave						
Të ardhurat nga taksat e ndara që do të përdoren për ekualizimin e të ardhurave (Biznesi i Vogël + Taksa e Automjeteve + Taksa mbi transferimin e pasurisë nga personat juridik)						1,767,862,764
Të ardhurat kombëtare për frymë (TAKPF), Të ardhura për frymë (TAPF)						536
Nëse NJVV-të kanë TAPF nën	80%	të TAKPF, atëherë ato kompensohen me	100%	të diferencës	Madhësia e ekualizimit fiskal (fondet që duhet të shtohen)	344,605,444
duke u marrë NJVV-ve me të ardhura për frymë mbi	120%	të mesatares kombëtare (TAKPF)	50%	të diferencës	Fondet që efektivisht shkurtohen	271,142,099
Koeficienti i rishpërndarjes						0.79

Njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë të ardhura për frymë (TAPF) nën 80% mesatares kombëtare (TAKPF) prej 536 lekë/frymë, do të kompensohen me 100% të diferencës ndërmjet të ardhurave të tyre për frymë dhe mesatares kombëtare. Kjo llogaritje tregon sa fonde do duhej t'u shtoheshin njësitë me të ardhura më të ulta për ti sjellë ato në nivelin prej 429 lekë/frymë (ku $536 \times 80\% = 429$ lekë). Për të sjellë të gjitha bashkitë me të ardhura më “të ulta” në nivelin prej 80% të mesatares kombëtare, njësitë me të ardhura më të larta se 120% e mesatares kombëtare, (pra me TAPF mbi 643 lekë/frymë) do t'u merret 50% e diferencës midis të ardhurave të tyre për frymë dhe 120% të mesatares kombëtare. P.sh., nëse një njësi e vetëqeverisjes vendore ka të ardhura për frymë prej 1200 lekë/frymë, sipas formulës së mësipërme asaj do ti zbriten 278 lekë/frymë $\{ (1200 - (120\% \times 536)) \times 50\% = 278 \text{ lekë/banor} \}$. Kjo llogaritje në fund tregon sa janë fondet realisht të disponueshme të cilat mund të transferohen nga njësitë me të ardhura më të larta tek ato më të ultat. Sistemi balancohet automatikisht nëpërmjet një koeficienti të rishpërndarjes i cili përcaktohet nga raporti midis fondeve disponibël për ekualizim dhe fondeve të nevojshme për ekualizim. Për vitin 2019, fondet e nevojshme për ekualizim janë 344,605,444 lekë, ndërkohë që fondet e disponueshme për ekualizim që vijnë nga “taksimi” prej 50% të të ardhurave mbi 536 lekë/frymë i njësitë me të ardhura më të larta janë 271,142,099 lekë dhe për rrjedhojë koeficienti i rishpërndarjes është 0.79.

7. Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për Qarqet.

Qarqeve do t'u ndahen 500 milionë lekë, sipas një shume fikse, të barabartë për secilin nga 12 Qarqet, sipas popullsisë rezidente dhe sipas dendësisë së popullsisë në çdo qark kundrejt mesatares kombëtare. Sipas kriterit të parë, 20% e totalit të transfertës së pakushtëzuar të qarqeve (ose 100 milionë lekë) do të shpërndahet si një shumë fikse prej rreth 8.3 milionë lekë për secilin nga 12 Qarqet.

Përbërja e transfertës së pakushtëzuar për qarqet	500,000,000
Komponenti I: Shuma fikse për qarqet (në përqindje)	20%
Transferta e pakushtëzuar për t'u ndarë sipas shumës fikse	100,000,000
Shuma fikse e transfertës së pakushtëzuar për çdo qark	8,333,333

Sipas kriterit të dytë, 50% e transfertës së pakushtëzuar (ose 250 milionë lekë) do të ndahet përpjesëtimisht sipas popullsisë rezidente në çdo qark, kundrejt popullsisë totale. Të dhënat për popullsinë e qarqeve ndjekin të njëjtin rregullim të bërë për popullsinë e bashkive.

Komponenti II: Ndarja sipas banorëve rezidentë efektivë (në përqindje)	50%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas numrit të banorëve rezidentë efektivë	250,000,000
Transferta e pakushtëzuar për frymë (Banorë rezidentë efektivë)	74

Sipas kriterit të tretë, 30% e transfertës së pakushtëzuar (ose 150 milionë lekë) do të ndahen mbi bazën e dendësisë së popullsisë në çdo qark, kundrejt dendësisë mesatare kombëtare.

Komponenti III: Ndarja sipas dendësisë së popullsisë (në përqindje)							30%
Transferta e pakushtëzuar që shpërndahet sipas dendësisë së popullsisë							150,000,000
Mesatarja kombëtare e dendësisë së popullsisë							119 banorë/km ²
Transferta për frymë nga komponenti i dendësisë së popullsisë							188 lek/banorë
Kufijtë e dendësisë së popullsisë si % ndaj mesatares kombëtare	Koeficientët	Numri i Qarqeve që përfitojnë	Dendësia e popullsisë për grup	Popullsia për çdo grup	Shuma e shtuar për secilin grup	% e shpërndarjes për grup	
Kufiri 1	90%	0,3	4	106.7	918,119	51,828,547	34%
Kufiri 2	65%	0,5	3	77.0	668,919	62,687,560	42%
Kufiri 3	35%	1,0	2	41.5	190,458	35,483,893	24%
Totali			9		1,777,496	150,000,000	

Qarqet me dendësi më të ulët të popullsisë, duke prezumuar kosto më të larta për ofrimin e shërbimeve dhe/ose kapacitet fiskal më të ulët, do të përfitojnë fonde shtesë nëpërmjet koeficientëve të përcaktuar më sipër për secilin nga tre grupet. Qarqet janë ndarë në tre grupe të ndryshëm sipas raportit mes dendësisë së tyre të popullsisë dhe mesatares kombëtare. Kufijtë e ndarjes së grupeve ndjekin ngjashmërinë e raportit të dendësisë ndaj mesatares kombëtare. Kështu, nëse një Qark ka një dendësi të popullsisë nën 35% të mesatares kombëtare, që nënkupton mesatarisht më pak se 41 banorë për km², kundrejt mesatares kombëtare prej 119 banorë për km², dhe një popullsi prej 93,225 banorësh rezidentë, atëherë popullsia e atij qarku shumëzohet me koeficientin shtesë përkatës (+1) dhe transfertën për frymë prej 188 lekë për banor, duke rezultuar në një shtesë fondesh prej 17,526 lekë (i logaritur në këtë mënyrë: 93,225*1*188).

ANEKS 2 KRITERET E SHPËRNDARJES SË FONDIT REZERVË

Nivelet e Pushtetit Vendor	Kriteret
A. Për bashkitë	- Kompensim për ndonjë gabim në përlogaritjen e kriterëve të formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2019. - Për funksionet e reja të transferuara në bashkitë që nga viti 2016. - Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive.
B. Për qarqet	Për shpenzime të ndryshme që mund të nevojiten gjatë vitit.

Shuma që akordohet nga fondi rezervë për njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk duhet të kalojë 50 përqind të nivelit të transfertës së pakushtëzuar të akorduar me ligjin e buxhetit të vitit 2019.

Pjesa e papërdorur e fondit rezervë në vitin buxhetor 2019, kalon në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2020.

Procedurat për alokimin e këtij fondi përcaktohen në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit të vitit 2019.

ANEKSI 3 FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE DHE PROGRAMI PËR INFRASTRUKTURËN VENDORE DHE RAJONALE

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.

2. Për vitin 2019, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.

3. Shpërndarja e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve sipas projekteve kryhet nga Komiteti për

Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

- | | |
|---|------------------|
| 1. Kryeministrin | Kryetar |
| 2. Zëvendëskryeministrin | Zëvendëskryetar; |
| 3. Ministrin e Financave dhe Ekonomisë | anëtar; |
| 4. Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë | anëtar; |
| 5. Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | anëtar; |
| 6. Ministrin e Kulturës | anëtar; |
| 7. Ministrin e Brendshëm | anëtar; |
| 8. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë | anëtar; |
| 9. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore | anëtar; |
| 10. Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë | anëtar; |

Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari.

4. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton:

- a) Specifikimet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e grantit të arsimit;
- b) Shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi;

5. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces.

Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë mund të kërkojë rialokime midis projekteve të FZHR-së, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

6. Thirrjet për aplikim në Fondin e Zhvillimit të Rajoneve për vitin buxhetor mund të bëhen që në Nëntor të vitit paraardhës.

7. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

8. Sekretariati teknik për grantin për arsimin ngrihet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është një njësi pranë Kryeministrit.

9. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit. Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

Programi buxhetor për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

1. Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.

2. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financim e projekteve të reja kryhen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Subjektet aplikuese për fondet e programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Autoriteti kontraktues dhe zbatues është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

4. Nga fondi për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces me burim financimi ish-Fondin e Zhvillimit të Rajoneve-Infrastruktura Vendore dhe Rajonale. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të FSHZH-së, në përputhje me ecurinë e projektit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit mund të kërkojë rialokime midis projekteve, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

5. Rregulla të hollësishme lidhur me funksionimin e të gjithë procesit që nga shpallja e thirrjes deri në aprovimin për financim, si dhe raportimin e autoriteteve kontraktuese do të miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

ANEKS 4

PËR FUNKSIONET E TRANSFERUAR NË VITIN 2016

1. Konviktet e arsimit parauniversitar

Në transfertën e vitit 2019, disa bashkive i janë akorduar fondet për konviktet e arsimit

parauniversitar. Në këtë transfertë përfshihen: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator), shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime.

Shpenzimet për personelin (paga dhe sigurime shoqërore) janë llogaritur mbështetur mbi numrin e punonjësve për secilin konvikt sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 502, datë 16.04.2008, “Për administrimin e konvikteve të sistemit arsimor parauniversitar” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1710, datë 29.12.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 502, datë 16.04.2008”, për punonjësit edukative (zëvendës drejtor dhe edukator).

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë para fillimit të vitit buxhetor 2019, duhet të dërgojë në njësitë e vetëqeverisjes vendore gjithë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me pagat dhe sigurimet shoqërore për konviktet e arsimit parauniversitar.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre konvikteve, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mbështeten në kuadrin rregullator që ka përdorur Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

2. Qëndrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën e vitit 2019 të bashkive, Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Kuçovë dhe Kukës i janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit shërbyes dhe shpenzime operative për qendrat, “Lira”, Berat, “Balash”, Elbasan, “Shpresa” Shkodër, Vau i Dejës dhe qendrat ditore të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për bashkitë Kuçovë dhe Kukës.

Për llogaritjen dhe kryerjen e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore të personelit të këtyre qendrave bashkitë Berat, Elbasan, Shkodër, Vau i Dejës, Kuçovë dhe Kukës do të mbështeten në kuadrin rregullator që përdor Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

3. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MZSH)

Në transfertën e vitit 2019, të bashkive është akorduar fondi për funksionin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ministria e Brendshme duhet t’ju dërgojë bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin e këtij shërbimi, kuadrin ligjor dhe të dhëna të tjera që disponon të cilat janë të lidhura me shërbimin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

4. Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar

Në transfertën e vitit 2019, njësitë e vetëqeverisjes vendore i janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar. Në fondet e personelit ndihmës të arsimit parauniversitar nuk përfshihet arsimi i mesëm profesional.

Në menaxhimin e funksioneve të arsimit parauniversitar njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të mbështeten në ligjin nr.69, datë 21.06.2012, “Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr.48, datë 23.07.2018).

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, para fillimit të vitit buxhetor 2019, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor, personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

5. Rrugët rurale

Në transfertën e vitit 2019, njërive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në rrugët rurale.

6. Administrimi i pyjeve

Në transfertën e vitit 2019, njërive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për Shërbimin Pyjor. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, para fillimit të vitit buxhetor 2019, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me funksionimin e këtij shërbimi, si dhe për pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

7. Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e 2019, njërive të vetëqeverisjes vendore i është akorduar fondi për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, para fillimit të vitit buxhetor 2019, duhet të dërgojë në bashkitë përkatëse kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me këtë shërbim.

Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet t'ju dërgoj bashkive të gjithë dokumentacionin që lidhet me personelin, mjetet, asetet dhe të dhëna të tjera që disponon, të cilat janë të lidhura me shërbimin.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit në këtë sektor.

8. Klubet sportive shumësportëshe , “Partizani” dhe “Studenti”

Në transfertën e vitit 2019, bashkisë Tiranë i janë akorduar fondet për personelin dhe shpenzimet operative të klubeve sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, para fillimit të vitit buxhetor 2019, duhet të dërgojë në bashkinë Tiranë kuadrin ligjor dhe nënligjor lidhur me dosjet personale të punonjësve, pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e klubeve sportive shumësportëshe “Partizani” dhe “Studenti”.

Standardet dhe kriteret e ofrimit të shërbimit do të bëhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi. Bashkia Tiranë mund të shtojë fonde nga të ardhurat e veta për të rritur cilësinë e shërbimit në këto klube.

